



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOLEGJI ZGJEDHOR GJYQËSOR
TIRANË

Nr.11 Regj.Them.
Datë Rregj.11.04.2023

Nr.11 VENDIMI
Datë 18.04.2023

V E N D I M
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor i mbledhur pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë me trup gjykues të përbërë nga:

Gjyqtare: **Esmeralda XHILI** (*Relatore*)
Gjyqtare: **Blerona HASA** (*Anëtare*)
Gjyqtare: **Emona MUÇI** (*Anëtare*)
Gjyqtare: **Alma KOLGJOKA** (*Anëtare*)
Gjyqtare: **Marsela DERVISHI** (*Anëtare*)

me sekretare gjyqësore Ermelinda Nuraj, sot më datë 18.04.2023, në seancë gjyqësore me dyer të hapura, mori në shqyrtim çështjen me nr.11 akti, datë 11.04.2023 që i përket:

PADITËS: **Partia Aleanca Progresiste LZHK**, përfaqësuar nga Kryetari i Partisë Dashamir Shehi i përfaqësuar nga Z.Fabian Topollari.

IPADITUR: **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**, përfaqësuar në gjykim me autorizim me nr. 3879 Prot datë 17.04.2023 nga Z.Erdal Mema.

OBJEKTI: Anullimin e Vendimit të Komisionit të Ankesave dhe Sanksioneve (KAS) datë 05.04.2023 për shqyrtimin e kërkesës nr. 45 datë 02.04.2023 të KAZAZ nr. 53.

BAZA LIGJORE: Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë i ndryshuar; Kodi i Procedurës Administrative i ndryshuar, neni 23.

Kolegji Zgjedhor, në seancën e datës 18.04.2023, pasi dëgjoi pretendimet e fundit të palës paditëse që kërkoi pranimin e padisë sipas objektit, si dhe palës së paditur që kërkoi rrëzimin e padisë,

V Ë R E N:

1. Se pala paditëse, subjekti Partia Aleanca Progresiste LZHK i është drejtuar Kolegjit Zgjedhor, duke depozituar pranë Gjykatës Administrative të Apelit, padinë me objekt *“Anullimin e vendimit nr. 50, datë 06.04.2023 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve”*. Referuar përcaktimeve të Kodit Zgjedhor, brenda afatit ligjor, u caktua seanca për gjykimin e kërkesëpadisë së paraqitur, duke iu kërkuar edhe palës së paditur paraqitja e të gjithë dokumentacionit përkatës, lidhur me vendimmarrjen që kundërshtohet nëpërmjet kësaj kërkesëpadie.

I. FAKTET E ÇËSHTJES:

2. Presidenti i Republikës së Shqipërisë, me Dekretin nr. 13864, datë 24.10.2022, ka caktuar datën 14 maj 2023, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

3. Pala paditëse, partia politike “Aleanca Progresiste LZHK”, me vendimin nr. 173, datë 14.03.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, ndryshuar me vendimin nr. 30, datë 21.03.2023 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve është regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

4. Në zbatim të parashikimeve të nenit 70 të Kodit Zgjedhor, si dhe të Udhëzimit nr.1, datë 18.01.2023 për *“Përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”* të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, pala paditëse partia “Aleanca Progresiste LZHK” ka depozituar në datë 27.03.2023 në KZAZ nr. 53 të bashkisë Prrenjas, dokumentacionin për regjistrimin e listës shumëmemërore të partisë për kandidatët për anëtarë të këshillit bashkiak.

5. KZAZ nr. 53 e bashkisë Prrenjas, pasi konstatoi parregullsi në dokumentacionin e paraqitur, përkatësisht materialet e depozituara për tre nga kandidatët e listës të cilat nuk ishin origjinale por fotokopje, i la afat 3 ditë kohë subjektit për korrigjimin e dokumenteve, duke njoftuar me shkresën nr. 24 prot, datë 28.03.2023 *“Kërkesë për plotësim dokumentacioni”* përfaqësuesin e autorizuar të subjektit zgjedhor.

6. Në vijim KZAZ-ja nr. 53, bashkia Prrenjas, datë 30.03.2023, me vendimin nr. 20 *“Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e listës së kandidatëve për këshillat vendorë propozuar nga Partia “Aleanca Progresiste LZHK”, vendosi:*

“Mosregjistrimin e listës shumëmemërore për kandidatët për këshillin bashkiak në bashkinë Prrenjas të paraqitur nga subjekti zgjedhor partia “Aleanca Progresiste LZHK”, për arsye se dokumentacioni ishte i parregullt”.

7. Pala paditëse duke mos qenë dakord me vendimin nr. 20, datë 30.03.2023 të Bashkisë Prrenjasi është drejtuar Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, me kërkesë ankimore, ku pretendon se; *“nuk kishte marrë dijeni për plotësimin e dokumentacionit të parregullt dhe kërkon shfuqizimin e vendimit nr. 20, datë 30.03.2023 të KZAZ-së nr. 53, Prrenjas dhe regjistrimin e listës shumëmemërore për kandidatët për këshillin bashkiak në bashkinë Prrenjas të paraqitur nga subjekti zgjedhor “Aleanca Progresiste LZHK”*.

8. Në seancën e datës 06.04.2023, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve mori në shqyrtim kërkesën ankimore të palës paditëse Partia “Aleanca Progresiste LZHK”, në prani të palës ankuese, përfaqësuar nga z. Fabian Topollari, të përfaqësuesit të KQZ-së, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm z. Ylli Merkaç, dhe anëtarë të KZAZ nr. 53, bashkia Prrenjas.

9. Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, në përfundim të hetimit administrativ, ka disponuar me vendimin nr. 50, datë 06.04.2023, bazuar në nenin 143 pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash në emër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, vendosi:

“1. Rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 45, datë 02.04.2023, të paraqitur nga subjekti zgjedhor “Aleanca Progresiste LZHK”.

2. Lënien në fuqi të vendimit nr. 20, datë 30.03.2023 të KZAZ nr. 53, bashkia Prrenjas.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.”.

10. Referuar vendimit të marrë nga Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve rezulton se:

1. Referuar parashikimeve të Kodit Zgjedhor, përkatësisht nenit 67, pikat 1 dhe 2, përzgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, kandidati për kryetar të njësisë së qeverisjes vendore dhe lista e kandidatëve për këshillat vendor, së bashku me dokumentet e kandidimit, depozitohen dhe regjistrohen në KZAZ-në që mbulon njësinë e qeverisjes vendore.

2. Neni 73 i Kodit, ashtu dhe neni 12 i Udhëzimit nr. 01, datë 18.01.2023 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit” të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, përcaktojnë se KZAZ-ja, pasi merr në dorëzim dokumentacionin përkatës verifikon rregullsinë e tij dhe nëse vëren parregullsi apo mospërmbushje të kërkesave të Kodit Zgjedhor, ia kthen ato subjekteve zgjedhore për korrigjim jo më vonë se 45 ditë përpara datës së zgjedhjeve. Dokumentacioni i korrigjuar më pas depozitohet jo më vonë se 42 ditë përpara datës së zgjedhjeve. Vendimi për miratimin ose refuzimin e dokumentacionit përfundimtar merret brenda 48 orëve nga depozitimi i tyre.

3. Në rastin konkret, partia “Aleanca Progresiste LZHK” ka depozituar në datën 27.03.2023 në KZAZ nr. 52 të bashkisë Prrenjas, dokumentacionin e për regjistrimin e listës shumëmemërore të partisë për kandidatët për anëtarë të këshillit bashkiak.

4. Anëtarët e KZAZ-së nr. 53 Prrenjas, pasi kanë konstatuar parregullsi në dokumentacionin e paraqitur nga subjekti zgjedhor partia “Aleanca Progresiste LZHK”, përkatësisht për depozitimin e formularëve jo origjinalë të dekriminalizimit për tre nga kandidatët e listës shumëmemërore, të cilit e kishin dorëzuar këtë material fotokopje, si dhe për mungesën e dokumentin që vërteton zotërimin e mandatit nga Kuvendi apo Këshilli Bashkiak, kanë njoftuar përfaqësuesin e subjektit zgjedhor për plotësimin dhe korrigjimin e këtij dokumentacioni.

5. Pretendimi në seancën e shqyrtimit pranë KAS, se subjekti zgjedhor nuk kishte marrë dijeni për plotësimin e të metave të dokumentacionit nuk qendron, pasi anëtarët e KZAZ-së nr. 53 provuan se ky njoftim është bërë me anë të shkresës nr. 24 prot., datë 28.03.2023 “Kërkesë për plotësim dokumentacioni”, që i është dërguar përfaqësuesit të autorizuar të subjektit zgjedhor. Në përfundim të afatit të mësipërm, në datën 30.03.2023, subjekti zgjedhor ka ridepozituar dokumentacionin, ku anëtarët e KZAZ-së përsëri kanë konstatuar parregullsi, përkatësisht në

formularët e vetëdeklarimit që ishin përsëri fotokopje dhe në vërtetimin nga Kuvendi apo Këshilli Bashkiak për zotërimin e mandatit që ishte fotokopje.

6. Për këto arsye, bazuar në pikën 2 të nenit 73 të Kodit Zgjedhor, morën vendimin nr. 20, datë 30.03.2023 për mosregjistrimin e listës shumëmemërore për shkak të parregullsive në dokumentacion. Nisur nga fakti se megjithë njoftimin e kryer nga ana e KZAZ-së, subjekti zgjedhor përsëri nuk plotësoi të metat e dokumentacionit të kërkuar, KAS çmon se anëtarët e KZAZ-së nr. 53, Prrenjas, kanë vepruar në përpruthje me ligjin, në zbatim të kompetencave të tyre”.

11. Ky vendim i KAS kundërshtohet në këtë gjykim nga Partia Aleanca Progresiste LZHK, e cila në kërkesëpadi dhe gjatë gjykimit, nëpërmjet përfaqësuesi të tij, ka pretenduar se:

- *Paditësi ka dorëzuar brenda afateve ligjore, nëpërmjet personit të autorizuar nga kryetari i partisë, Listën shumëmemërore pranë KZAZ 53 së bashku me dokumentacionin e kandidimit të kandidateve të LZHK për këshillin bashkiak Prrenjas. Në procesverbalin e dorëzimit të dokumentave të kandidimit është evidentuar se për 4 prej tyre ishin të llojit fotokopje dhe jo origjinale. Për këtë arsye, në datë 30.03.2023 është bërë plotësimi i dokumentacionit me të metat e evidentuara nëpërmjet procesverbalit të datës 30.03.2023. Po atë ditë, në orën 21:04 KZAZ nr. 53, merr vendim për refuzimin e listës shumëmemërore të partisë LZHK me arsyetimin se kishte disa mangësi. Ky vendim i është komunikuar paditësit nëpërmjet shkresës nr. 32 prot datë 30.03.2023.*
- *Konkretisht sipas pretendimit të KZAZ mungonte vërtetimi i zotërimit të mandatit të deputetit sepse ishte i formës fotokopje dhe kishte mangësi në dokumentat e kandidatëve Rigërs Karriqi dhe Alketa Hoxha. Ky vendim për refuzimin e listës i është komunikuar nëpërmjet shkresës së KZAZ nr.53 me nr. 32 prot, datë 30.03.2023 subjektit Aleanca Progresiste LZHK.*
- *Këtë vendim, pala paditëse brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar në KAS me arsyetimin se origjinali i vërtetimit të mandatit është dorëzuar në KQZ, ndërkohë që origjinali i dokumentave të kandidimit i firmosur në mënyrë të rregullt nga kandidatët është dorëzuar bashkë me të tjerët edhe për kandidatet Rigërs Karriqi dhe Alketa Hoxha. Provë e dorëzimit të dokumentave të plota pranë KZAZ për këta kandidate ishte një kopje e këtyre dokumentave ku evidentohet se këto dokumenta ishin të firmosura në të gjitha faqet dhe në mënyrë të rregullt nga kandidatët Alketa Hoxha dhe Rigërs Karriqi.*
- *KAS me shumicë votash rrëzoi ankesën e Partisë Aleanca Progresiste LZHK me arsyetimin se u vërtetua që Partia Aleanca Progresiste LZHK kishte depozituar vërtetimin origjinal të zotërimit të mandatit pranë KQZ brenda afatit ligjor si dhe u vërtetua që ky subjekt kishte dorëzuar në afat edhe origjinalin e dokumentave të kandidimit për kandidaten Alketa Hoxha, por nuk u vërtetua se subjekti kishte dorëzuar dokumentat origjinale të kandidimit për kandidatin Rigërs Karriqi.*
- *Ky vendim është i pambështetur në prova dhe në ligj pasi: Sipas dispozitave ligjore në fuqi, konkretisht nenin 73 të Kodit Zgjedhor, KZAZ duhet të lajmërojë subjektin politik për çdo mangësi që ka dokumentacioni i saj i kandidimit jo më vonë se 45 ditë përpara zgjedhjeve. Ky lajmërim duhet t'i bëhet subjektit dhe duhet të specifikojë konkretisht mangësitë e dokumentacionit si e vetmja mënyrë që ai të mund t'i plotësojë ato. Pretendimi se subjekti është lajmëruar nëpërmjet shkresës me nr. 24 prot. datë 28.03.2023 për mungesën e dokumentave origjinale të kandidimit për kandidatin Rigërs Karriqi nuk është i saktë sepse: Ky dokument i drejtohet shtetasit Fahri Lacka dhe jo subjektit Aleanca Progresiste LZHK. Shtetasi Fahri Lacka është i autorizuar nga kryetari i partisë për nënshkrimin e listës*

shumëmërorë të partisë LZHK për bashkinë Perrenjas dhe për depozitimin e saj pranë KZAZ Perrenjas dhe nuk ushtron asnjë funksion tjetër partiak që të mund të jetë personi që përmbush detyrimet e subjektit zgjedhor. KZAZ në këtë rast për çdo mangësi duhet të lajmëronte subjektin zgjedhor si e vetmja mënyrë që ai të mund të plotësonte mangësitë.

- *Pavarësisht kësaj, shkresa lajmërim për mangësitë e dokumentave të kandidimit të kandidatit Rigers Karriqi nuk i është komunikuar asnjëherë as vete shtetasit Fari Lacka për shkak se kjo është një shkresë pa adresë. Me këtë shkresë jemi vënë në dijeni vetëm pas zbardhjes së vendimit të KAS që linte në fuqi vendimin për refuzimin e listës shumëëmërorë të LZHK për bashkinë Perrenjas. Gjatë shqyrtimit të kërkesës ankimore nga ana e KAS, duke qenë se nuk është vënë në dispozicion e gjithë praktika dokumentare e KZAZ 53 për refuzimin e listës shumëëmërorë të paditësit në Bashkinë Perrenjas, paditësi e ka pasur krejtësisht të paqartë arsyen se përse i është refuzuar lista sepse në dijeni të tij të gjithë dokumentat e kandidimit të kandidatëve ishin dorëzuar më parë pranë KZAZ.*
- *Edhe nëse pranojmë se lajmërimi i mangësive të dokumentacionit për kandidatit Karriqi është bërë në mënyrë të rregullt, përsëri sipas nenit 73 të Kodit Zgjedhor subjekti do duhet të kishte kohë për plotësimin e këtyre mangësive deri 42 ditë përpara datës së zgjedhjeve, pra, deri në datën 02.04.2023 subjekti ka pasur kohë të plotësonte të gjitha mangësitë e evidentuara. Në këtë rast jo vetëm nuk është pritur ky afat por KZAZ ka marrë vendim për refuzimin e listës 3 ditë përpara afatit që ka pasur subjekti për plotësimin e dokumentacionit.*
- *Problematik bëhet zbatimi i ligjit në këtë rast kur edhe KAS lë në fuqi këtë vendim pavarësisht se në ankimin e subjektit LZHK të datës 02.04.2023, i cili u shqyrtua nga KAS në datë 05.04.2023, subjekti pretendon se zotëron një kopje origjinale të dokumentacionit të këtij kandidati dhe mund t’ia vinte në dispozicion edhe KAS nëse do t’i jepej kohë. Arsyeja që nuk vendosëm një kopje origjinale të dokumenteve të kandidatit Karriqi bashkëlidhur ankimit të KAS, ishte fakti se në ishim në kushtet e padijenisë të pretendimit të KZAZ 53 që këto dokumenta mungonin. Për këtë arsye i vëmë në dispozicion Kolegjit një kopje origjinale të këtyre dokumentave të cilat janë dorëzuar të tilla edhe pranë KZAZ brenda afatit ligjor për dorëzimin e dokumentacionit.*
- *Për të gjitha këto arsye, pala paditëse kërkon pranimin e kërkesëpadisë sipas objektit.*

12. Pala e paditur Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet përfaqësuesit të tij, gjatë gjykimit ka pretenduar se:

- *Partia politike “Aleanca Progresiste LZHK” ka depozituar në datën 27.03.2023 në KZAZ nr. 53 të bashkisë Prrenjas, dokumentacionin e për regjistrimin e listës shumëëmërore të partisë për kandidatët për anëtarë të këshillit bashkiak.*
- *Anëtarët e KZAZ-së nr. 53 Prrenjas, kanë konstatuar parregullsi në dokumentacionin e paraqitur nga subjekti zgjedhor partia “Aleanca Progresiste LZHK”, përkatësisht për depozitimin e formularëve jo origjinalë të dekriminalizimit për tre nga kandidatët e listës shumëëmërore, të cilit e kishin dorëzuar këtë material fotokopje, si dhe për mungesën e dokumentin që vërteton zotërimin e mandatit nga Kuvendi apo Këshilli Bashkiak, kanë njoftuar përfaqësuesin e subjektit zgjedhor për plotësimin dhe korrigjimin e këtij dokumentacioni.*
- *Në përfundim të afatit të mësipërm, në datën 30.03.2023, subjekti zgjedhor ka ridepozituar dokumentacionin, ku anëtarët e KZAZ-së përsëri kanë konstatuar parregullsi, përkatësisht në formularët e vetëdeklarimit që ishin përsëri fotokopje dhe në vërtetimin nga Kuvendi apo Këshilli Bashkiak për zotërimin e mandatit që ishte fotokopje. Për këto arsye, bazuar*

në pikën 2 të nenit 73 të Kodit Zgjedhor, morën vendimin nr. 20, datë 30.03.2023 për mosregjistrimin e listës shumemërore për shkak të parregullsive në dokumentacion.

- *Referuar pretendimit të paditësit se subjekti nuk është njoftuar për plotësimin e të metave në dokumentacion, nuk qëndron, pasi anëtarët e KZAZ-së nr. 53 provuan në seancën e shqyrtimit pranë KAS se ky njoftim është bërë me anë të shkresës nr. 24 prot, datë 28.03.2023 “Kërkesë për plotësim dokumentacioni”, që i është dërguar përfaqësuesit të autorizuar nga vetë ky subjekti zgjedhor.*
- *Përfundimisht, nisur nga fakti se megjithë njoftimin e kryer nga ana e KZAZ-së, subjekti zgjedhor përsëri nuk plotësoi të metat e dokumentacionit të kërkuar, kërkojmë:*
- *Rrëzimin e kërkesë padisë të paraqitur nga paditësi Partia “Aleanca Progresiste LZHK”*
- *Lënien në fuqi të vendimit nr. 50, datë 06.04.2023 “Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 45, datë 02.04.2023 të depozituar nga subjekti zgjedhor ‘Aleanca Progresiste LZHK’”, të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve”.*

II. ARSYETIMI I KOLEGJIT:

13. Kodi Zgjedhor përcakton saktësisht rregullat përkatëse, lidhur me procedurat, dokumentacionin e kandidimit në zgjedhje, si dhe njëkohësisht edhe rregullat përkatëse lidhur me verifikimin e këtij dokumentacioni. Përveç normimeve të bëra në Kodin Zgjedhor, rezulton se Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka nxjerrë edhe *Udhëzimin nr. 01, datë 18.01.2023 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit” të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.* Është e kuptueshme që përcaktimi i këtyre rregullave lidhur me depozitimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet përkatëse dhe procedurat e verifikimit të dokumentacionit shërben për të garantuar administrimin efektiv të të gjithë procesit zgjedhor. Normimi i këtyre rregullave në Kodin Zgjedhor dhe në vijim, detajimi i tyre në udhëzimet përkatëse synon disiplinimin e subjekteve zgjedhorë në kuadër të mbarëvajtjes së procesit zgjedhor, por gjithmonë duke mbajtur parasysh parimet kryesore, për të garantuar të drejtën për t'u zgjedhur, të drejtën për të arritur zgjedhje të lira, të drejta, të barabarta. Duke marrë parasysh sa më lart, merr rëndësi të posaçme respektimi i rregullave përkatëse, për të cilat subjektet zgjedhorë janë vënë në dijeni. Rregullat lidhur me depozitimin e dokumentacionit janë bërë të njohura për subjektet zgjedhorë dhe në vijim respektimi i tyre i takon pikërisht këtyre subjekteve fillimisht dhe në vijim strukturave përkatëse të KQZ-së. Kolegji vlerëson se interpretimi i rregullave mbi afatet e plotësimit të dokumentacionit nga kandidatët, duhet të bëhet në mënyrë pajtuese me Kushtetutën dhe parimet themelore të shtetit të së drejtës.

14. Në Kodin Zgjedhor neni 67 përcakton se:

“1. Partia politike ose koalicioni zgjedhor, në kuptim të nenit 65, që është regjistruar në KQZ si subjekt zgjedhor për zgjedhjet në Kuvend, depoziton në KQZ listën shumemërore të kandidatëve të tij për çdo zonë zgjedhore jo më vonë se 50 ditë para datës së zgjedhjeve. Për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, kandidati për kryetar të njësisë së qeverisjes vendore dhe lista e kandidatëve për këshillat vendorë regjistrohen në KZAZ-në që mbulon njësinë e qeverisjes vendore brenda afatit të përcaktuar në këtë pikë. KZAZ-ja dorëzon një kopje të listës në KQZ brenda 48 orëve. 2. Në zbatim të paragrafit të dytë të pikës 1 të këtij neni, lista e subjektit depozitohet në KQZ në rastet kur territori i njësisë së qeverisjes vendore nuk mbulohet nga një KZAZ e vetme”.

Nisur nga sa më lart, Kodi Zgjedhor përcakton qartësisht se subjekti zgjedhor, tashmë i regjistruar në KQZ për zgjedhjet, depoziton listën shumemërore të kandidatëve të tij për zonën zgjedhore

përkatëse, në afatin që përcakton “jo më vonë se 50 ditë” nga data e zgjedhjeve. Në funksion të respektimit të këtyre rregullave, i lind detyrimi subjektivit zgjedhor për depozitimin e listës shumëemërore, normalisht me dokumentacionin përkatës të plotësuar sipas ligjit dhe akteve përkatëse nënligjore. Në vijim, është detyrimi përkatës i KQZ për të proceduar me verifikimin e rregullsisë së dokumentacionit të kandidimit.

Neni 73 i Kodit Zgjedhor përcakton se:

“1. KQZ-ja ose, sipas rastit, KZAZ-ja verifikon rregullsinë e dokumentacionit të kandidimit dhe nëse vëren parregullsi apo mospërmbushje të kërkesave të këtij Kodi, ia kthen ato subjekteve zgjedhore për korrigjim jo më vonë se 45 ditë përpara datës së zgjedhjeve.

2. Dokumentacioni i korrigjuar depozitohet jo më vonë se 42 ditë përpara datës së zgjedhjeve. Vendimi për miratimin ose refuzimin e dokumentacionit përfundimtar merret brenda 48 orëve nga depozitimi i tyre...”

Konkretisht, në interpretim të dispozitës ligjore të sipërcituar, KQZ/strukturat e saj, verifikojnë rregullsinë e dokumentacionit të kandidimit. Ligjvënësi ka rregulluar në Kodin Zgjedhor edhe situatat kur dokumentacioni i paraqitur ka parregullsi. Pikërisht në nenin 73 normohet se KQZ/KZAZ në momentin që konstaton parregullsi, ia kthen subjekteve zgjedhore, dokumentacionin, me qëllim që të bëhet korrigjimi i tyre dhe të riparqiten sipas rregullave të normuara. Ligjvënësi ka përcaktuar edhe afatin maksimal të riparqitjes së dokumentacionit të korrigjuar/rregulluar, konkretisht jo më vonë se 42 ditë përpara datës së zgjedhjeve.

15. Në rastin objekt shqyrtimi, konstatohet se partia “Aleanca Progresiste LZHK” ka depozituar në datë 27.03.2023 në KZAZ nr. 52 të bashkisë Prrenjas, dokumentacionin për regjistrimin e listës shumëemërore të partisë për kandidatët për anëtarë të këshillit bashkiak. Anëtarët e KZAZ-së nr. 53 Prrenjas, pasi kanë konstatuar parregullsi në dokumentacionin e paraqitur nga subjekti zgjedhor partia “Aleanca Progresiste LZHK”, përkatësisht për depozitimin e formularëve jo origjinalë të dekriminalizimit për tre nga kandidatët e listës shumëemërore, të cilit e kishin dorëzuar këtë material fotokopje, si dhe për mungesën e dokumentin që vërteton zotërimin e mandatit nga Kuvendi apo Këshilli Bashkiak, kanë njoftuar përfaqësuesin e subjektivit zgjedhor për plotësimin dhe korrigjimin e këtij dokumentacioni. Sa më lart evidentohet edhe në dokumentacionin e paraqitur si provë në gjykim nga KQZ, ku në procesverbalin përkatës model, është bërë shënimi/vërejtje lidhur me parregullsi në dokumentacion/procesverbali datë 27.03.2023, konkretisht “deklaratë për pranimin e kandidimit-për tre kandidatë materialet janë fotokopje”. Gjithashtu, konstatohet se edhe në procesverbalin e mbajtur në datë 30.03.2023, mbi plotësimin e dokumentacionit, është bërë, ndër të tjera, shënimi në opsionin “vërejtje”, “për katër kandidatë plotësuese, njëra nga deklaratat fotokopje përsëri”, për vërtetim nga kuvendi apo këshilli bashkiak për zotërsimin e mandatit “fotokopje”, tek kërkesë për regjistrim e listës shumëemërore, bërë shënimi “e ndryshuar”. Në lidhje me sa më sipër, Kolegji Zgjedhor vlerëson se procesverbali model përbën një akt zyrtar me fuqi të plotë provuese bazuar në nenin 253 të K.Pr.Civile. Në këto kushte, sa kohë që është bërë vërejtje nga nënshkruesi përfaqësues i KZAZ Nr. 53, rezulton se provon faktin se dokumentacioni ka pasur parregullsi.

16. Në vlerësim të Kolegjit, subjekti zgjedhor ka pasur dijeni të plotë mbi “parregullsitë në dokumentacion”. Kjo gjë evidentohet nga dokumentacioni i paraqitur nga KQZ, por nisur edhe nga pohimet e bëra nga ana e përfaqësuesit të subjektivit zgjedhor, në seancë. Konkretisht, vetë përfaqësuesi i subjektivit zgjedhor parashtron se në procesverbalin e dorëzimit të dokumentave të

kandidimit është evidentuar se për 4 prej tyre ishin të llojit fotokopje dhe jo origjinale. Për këtë arsye, në datë 30.03.2023 është bërë plotësimi i dokumentacionit me të metat e evidentuara nëpërmjet procesverbalit të datës 30.03.2023. Kjo nënkupton, se ndryshe nga sa pretendon subjekti zgjedhor, kanë qenë në dijeni të parregullsive në dokumentacion dhe po kështu janë munduar që të plotësojnë parregullsitë, duke i dorëzuar dokumentacionin në datë 30.03.2023. Subjekti zgjedhor, përfaqësuesi parashtron se nuk i janë komunikuar të gjitha parregullsitë e evidentuara nga KZAZ përkatëse. Në vlerësim të Kolegjit, nuk ka asnjë arsye që mund të pranohet ky pretendim. KZAZ e ka përmbushur detyrimin për t'i evidentuar subjektit zgjedhor për parregullsi në dokumentacion. Ndërkohë që, rezulton se edhe pas plotësimeve përkatëse, sërish KZAZ-ja ka konstatuar se nuk janë plotësuar të gjitha parregullsitë dhe për këtë arsye ka vendosur refuzimin e regjistrimit të listës shumëemërore të kandidatëve të subjektit zgjedhor, palë paditëse në këtë gjykim, konkretisht me arsyetimin se formularët e vetëdeklarimit që ishin përsëri fotokopje dhe në vërtetimin nga Kuvendi apo Këshilli Bashkiak për zotërimin e mandatit që ishte fotokopje. Brenda afatit ligjor, është kundërshtuar vendimi përkatës i KZAZ pranë KAS. KAS, gjithashtu vendosi rrëzimin e kërkesës ankimore të subjektit zgjedhor dhe lënien në fuqi të vendimit të KZAZ nr.53 Bashkia Prrenjas. Vetë pala paditëse pretendon se KAS me shumicë votash rrëzoi ankesën e Partisë Aleanca Progresiste LZHK me arsyetimin se u vërtetua që Partia Aleanca Progresiste LZHK kishte depozituar vërtetimin origjinal të zotërimit të mandatit pranë KQZ brenda afatit ligjor si dhe u vërtetua që ky subjekt kishte dorëzuar në afat edhe origjinalin e dokumentave të kandidimit për kandidaten Alketa Hoxha, por nuk u vërtetua se subjekti kishte dorëzuar dokumentat origjinale të kandidimit për kandidatin Rigers Karriqi. Vetë pala paditëse parashtron se *KAS lë në fuqi këtë vendim pavarësisht se në ankimin e subjektit LZHK të datës 02.04.2023, i cili u shqyrtua nga KAS në dt.05.04.2023, subjekti pretendon se zotëron një kopje origjinale të dokumentacionit të këtij kandidati dhe mund t'ia vinte në dispozicion edhe KAS nëse do t'i jepej kohë. Arsyeja që nuk vendosem një kopje origjinale të dokumenteve të kandidatit Karriqi bashkëlidhur ankimit të KAS, ishte fakti se ne ishim në kushtet e padijenisë të pretendimit të KZAZ 53 që këto dokumenta mungonin. Për këtë arsye i vëmë në dispozicion Kolegjit një kopje origjinale të këtyre dokumentave të cilat janë dorëzuar të tilla edhe pranë KZAZ brenda afatit ligjor për dorëzimin e dokumentacionit.*

17. Nisur nga sa më lart, Kolegji vlerëson se dijenia e subjektit zgjedhor mbi mangësitë në dokumentacion evidentohet qartazi. Konkretisht, nga KZAZ është njoftuar mbi parregullsitë në dokumentacion dhe ka plotësuar vetëm një pjesë të tyre. Edhe përpara procedurës administrative pranë KAS, sërish subjekti nuk e ka pasur të administruar dokumentacion origjinal të kandidimit për kandidatin Rigers Karriqi, pasi vetë pohon se i ka kërkuar kohë KAS që të paraqiste këtë dokumentacion, në një kohë që procedura pranë KAS është zhvilluar pikërisht në datë 06.04.2023. Sa më lart, rezulton e provuar që dokumentacioni i paraqitur nga subjekti zgjedhor ka pasur mangësi, të cilat kanë qenë evidente, të bëra të njohura këtij subjekti dhe të paplotësuara mangësitë, edhe në procedurën e zhvilluar nga KAS. Pretendimi se subjekti zgjedhor nuk ka marrë dijeni nuk qëndron, pasi duke vlerësuar të gjithë procedurën e ndjekur nga KZAZ, qëndrimin që ka mbajtur subjekti zgjedhor pranë KZAZ (që ka plotësuar disa mangësi në datë 30.03.2023), qëndrimin që ka mbajtur subjekti zgjedhor pranë KAS, duke kërkuar kohë që të paraqesë dokumentacion origjinal për kandidatin eventual Rigers Karriqi, krijon bindjen tek Kolegji mbi faktin që subjekti zgjedhor ka qenë në dijeni të të gjitha mangësive në dokumentacion. Afatet e shkurtra që përcakton Kodi Zgjedhor dhe më tej udhëzimi i Komisionerit për verifikimin e dokumentacionit, plotësimin e parregullsive në dokumentacion, nënkupton faktin që strukturat e KQZ duhet të veprojnë shpejt, brenda rregullave përkatëse dhe gjithashtu të ketë dilijencë nga ana e tyre dhe nga ana e subjektit

zgjedhor, për të respektuar rregullat në paraqitjen e dokumentacionit dhe plotësimin e tyre kur janë të parregullta. E gjitha sa më lart në funksion të garantimit të së drejtës për t'u zgjedhur. Kolegji Zgjedhor vlerëson se mosregjistrimi i listës shumëemërore të kandidatëve të një subjekti zgjedhor është pasojë e vetë qëndrimit të mbajtur nga subjekti, në kushtet e provueshmërisë së dijenisë së tij, mbi procedurat e ndjekura dhe mbi parregullsitë e evidentuara në dokumentacion.

18. Kolegji vlerëson se pavarësisht pretendimeve të ngritura nga përfaqësuesi i subjektit zgjedhor, dijenia e tij mbi parregullsinë e dokumentacionit rezulton qartazi dhe në këtë aspekt, vlerësohet se drejt ka vepruar KZAZ përkatëse, që në momentin ka konstatuar, se edhe pas afatit të lënë, sërish nuk ishin plotësuar të gjitha parregullsitë, ka marrë vendimin për mosregjistrimin e listës shumëemërore të subjektit zgjedhor. Kolegji gjen të drejtë arsyetimin e bërë nga KAS, mbi faktin se megjithë njoftimin e kryer nga ana e KZAZ-së, subjekti zgjedhor përsëri nuk plotësoi të metat e dokumentacionit të kërkuar dhe KAS ka çmuar se anëtarët e KZAZ-së nr. 53, Prrenjas, kanë vepruar në përputhje me ligjin, në zbatim të kompetencave të tyre. Në këtë sens, Kolegji vlerëson se subjekti zgjedhor/pala paditëse nuk arriti të provonte përpara kolegjit, se vendimi i marrë nga KAS nuk ishte në përputhje me ligjin. Kolegji vlerëson se në gjykim u provua se procedura e ndjekur nga KZAZ përkatëse, është në përputhje me ligjin dhe drejt ka konkluduar KAS, mbi rrëzimin e kërkesës ankimore të subjektit zgjedhor Partia Aleanca Progresiste LZHK.

Në konkluzion të arsyetimit të lartpërmendur, Kolegji çmon të rrëzojë kërkesëpadinë e paraqitur nga Partia Aleanca Progresiste LZHK.

PËR KËTO ARSYE:

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, bazuar në nenin 158 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë,

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kërkesëpadisë së paraqitur nga Aleanca Progresiste LZHK.
 2. Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.
 3. Ky vendim është i formës së prerë dhe kundër tij nuk lejohet ankim.
- U shpall sot në Tiranë, në datë 18.04.2023.

GJYQTARE
Blerona HASA

GJYQTARE
Emona MUÇI

GJYQTARE
Alma KOLGJOKA

GJYQTARE
Marsela DERVISHI

GJYQTARE
Esmeralda XHILI